

L I G J
Nr.7780, datë 22.12.1993

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7651, DATË 21.12.1992 “PËR FESTAT ZYRTARE”

Në mbështetje të neneve 16 e 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Paragrafi i fundit i nenit 1 të ligjit nr.7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare” ndryshohet si vijon:

“Kur ditët e festave zyrtare të mësipërme bien ditën e shtunë ose të dielë, ditë pushimi do të jenë ditët pasardhëse të punës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.742, datë 24.12.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.